

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale / Direktorat za Zdravstvo i Socijalnu
Zaštitu / Department of Health and Social Welfare

Nr. 04-016/01-3807/24

dt: 11/01/2024

Njoftim për aplikim

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjilan ka hapur aplikimin për programin e bonus banimit .

Te drejtë aplikimi kanë të gjitha familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale dhe familjet me gjendje të rënd ekonomike.

Kriteret për përcaktimin e radhës dhe përparësisë për sigurimin e banimit për personat/familjet që aplikojnë janë:

- statusi i banimit
- lartësia e të ardhurave
- gjendja shëndetësore
- invaliditeti
- struktura e familjes

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:


- 1.Kërkesa me shkrim(kërkesa sipas formës standarde shtojcë nr.1 Udhëzimi administrativ, merret në zyret e DSHMS apo QSHQ);
- 2.Fotokopja e letërnjoftimit për parashtruesin e kërkesës;
- 3.Ekstrakti i lindjes për anëtarët e familjes të parashtruesit të kërkesës;
- 4.Çertifikata e bashkësisë familjare;
- 5.Çertifikata e vendbanimit ;
- 6.Të dhënat për anëtarët e punësuar(nga punëdhënësi) dhe burimet e të hyrave të rregullta;
- 7.Vërtetim nga Enti për punësim për të gjithë anëtarët e familjes të papunë;
- 8.Vërtetim mbi shkollimin e rregullt;
- 9.Të dhënat mbi gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës apo anëtarëve të familjes , të lëshuar nga ana e enteve shëndetësore të autorizuar ose të komisioneve profesionale;
- 10.Çertifikatën apo vërtetimin që nuk posedon pronë të paluatjshme;
- 11.Vendimi i Gjykatës(për rastet dhunë në familje);

12.Kontratën e noterizuar me qiradhënësin;

13.Konfirmimi i llogarisë bankare të parashtruesin e kërkesës.

Afati i aplikimit për programin e banimit është **15 ditë pune**, nga data **11.01.2024** deri **31.01.2024**

Vërejtje: Kërkesat e parashtruara jashtë afatit të aplikimit do të refuzohen nga ana e komisionit.



Drejtori i DSHMS-së

Donatina Hasani